

"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj 17/21

Tuzi, 21. 12 2021 god.

“Pijace / Tregu”

SHPK Tuzi / Tuz

PROGRAMI

I KRYERJES SË VEPRIMTARIVE KOMUNALE PËR VITIN 2022

Tuz, dhjetor 2021.godine

Përmbajtje

1. HYRJE	2
2.1. Të dhënat themelore identifikuese	2
Kryerësi i veprimtarive komunale është Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz, me seli në Tuz, në adresën p.n.....	2
2.2. Forma e organizimit.....	2
Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin për themelimin e Shoqërisë me përgjegjësiu të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz me seli në Tuz në adresën sa sjedištem u Tuzima na adresi, (Flet. Zyrt MZ – dispozitat komunale 040/21 e datës 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.	2
2.3. Aktet themeluese	2
2.4. Çështjet juridike – statusore Pravno – statusna pitanja	2
2.5. Struktura pronësore	3
Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz është themeluar si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar dhe si e tillë është në pronësi të Kuvendit të Komunës së Tuzit.	3
2.6. Organizimi i brendshëm dhe skema organizative	3
2.7. Veprimtaritë themelore dhe anësore që i kryen Shoqëria	5
2.8. Organet e udhëheqjes dhe drejtimit.....	5
3.1. Resurset njerëzore	7
3.3. Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale	7
3.4. Pajisjet dhe parku i makinave.....	7
4. QËLLIMET E SHOQËRISË	7
BAZAT PËR PËRPILIMIN E PROGRAMIT	8
Numri i planifikuar i të punësuarve sipas njësive organizative dhe në tërësi si dhe struktura e kualifikimit të tyre për vitin 2022 është dhënë në tabelën 1.	14
Tabela 1	14
12. POLITIKA E QMIMEVE	16

1. HYRJE

Në bazë të nenit 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Veprimtaritë Komunale (Flet. Zyrt. MZ, nr.55/16,74/16 dhe 66/19), është përcaktuar që veprimtaritë komunale të kryhen në bazë të Programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale.

Me Rregulloren mbi përmbajtjen më të përafërt të veprimtarive komunale dhe Raportit vjetor mbi realizimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale (Fl. Zyrt. E MZ, nr. 54/20) është përcaktuar përmbajtja e kryerjes së veprimtarive komunale.

Me këtë Program, Ushtuesi i detyrës planifikon shërbimin e shpenzimeve individuale komunale, duke dhënë në qira vendet e shitjes që gjenden në objektin e Tregut dhe prej tyre planifikon të realizojë të ardhurat. Me Programin e kryerjes së veprimeve komunale, Shoqëria „Pijace? Tregu“ Tuz, do të planifikojë që me mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe cilësore të objekteve të Tregut të kujdeset për të siguruar interesin publik dhe stabilitetin afarist.

2. TË DHËNAT THEMELORE MBI KRYERËSIN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

2.1. Të dhënat themelore identifikuese

Kryerësi i veprimtarive komunale është Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz, me seli në Tuz, në adresën p.n.

Themeluesi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz është Kuvendi i Komunës së Tuzit, numri amë 02628988 me seli në Tuz

2.2. Forma e organizimit

Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin për themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz me seli në Tuz në adresën, (Flet. Zyrt. MZ – dispozitat komunale 040/21 datë 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.

2.3. Aktet themeluese

Aktet mbi themelimin e Shoqërisë janë Akti mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz me seli në Tuz në adresën, (Flet. Zyrt MZ – dispozitat komunale 040/21 e datës 03.12.2021) , si dhe Statuti i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz numër 08-032/21 -14776, datë 01.12.2021.

2.4. Çështjet juridike – statusore

Me Ligjin mbi Veprimtaritë Komunale (Fl. Zyrt. MZ nr. 55/16, 74/16, 2/18, 66/19) përcaktohen veprimtaritë komunale dhe mënyra e kryerjes së veprimtarive komunale si dhe çështje tjera me rëndësi për veprimtaritë komunale.

Me Ligjin mbi Veprimtaritë Komunale është definuar se mirëmbajtja e tregjeve është veprimtari komunale për të cilën kryhet pagimi i shërbimeve dhe në pajtim me këtë paraqet veprimtari të konsumit individual komunal dhe është me interes publik.

Realizimi i interesit publik në rastin konkret është siguruar me themelimin e Shoqërisë, të cilës i është besuar mirëmbajtja dhe menaxhimi i objekteve të tregut si dhe mirëmbajtja e higjienës së përgjithshme në hapësirën e tregut dhe në objekte, si dhe në kryerjen e veprimtarisë shtesë që nuk kanë karakter të interesit publik, për ç' gjë Shoqëria mban evidencë të posaçme në librat e evidentimit.

Në bazë të Ligjit mbi Veprimtaritë Komunale është miratuar edhe Rregullorja mbi minimumin e kualitetit dhe vëllimit të punëve për kryerjen e veprimtarive komunale (Fl. Zyrt. MZ, nr. 054/20). Me rregulloren e cekur përfshihen kërkesat në aspektin e kualitetit dhe kuantitetit që duhet t'i plotësojnë tregjet.

Veprimtarinë e cekur, Ushtuesi do ta kryejë edhe në pajtim me Vendimin për tregjet (Fl. Zyrt. MZ – dispozitat komunale, 033/19 datë 14.08.202) me të cilin janë definuar kushtet dhe mënyra e organizimit, mirëmbajtjes dhe kryerjes së shërbimeve tregtare dhe shërbimeve në tregje, si objekte për ofrimin e shërbimeve komunale të konsumit individual komunal, që janë mënyrë të pazëvendësueshme të jetës dhe punës së qytetarëve, subjekteve ekonomike dhe subjekteve tjera e që janë në interesin publik.

Gjithashtu, në kryerjen e veprimtarive që janë të lidhura me veprimtarinë themelore Shoqëria do të veprojë edhe në pajtim me Ligjin mbi Tregtinë e Brendshme (Fl. Zyrt. MZ, nr 44/10), me të cilin përcaktohen kushtet e kryerjes së tregtisë në tregje.

Theksojmë se, përpos dispozitave të cekura që rregullojnë drejtpërdrejt veprimtarinë e kësaj Shoqërie, do të zbatohen edhe dispozita që rregullojnë çështje të posaçme, të rëndësishme për zbatimin dhe realizimin e veprimtarisë së regjistruar të kësaj Shoqërie (Ligji mbi Procedurën Administrative, Ligji mbi Marrëdhëniet Obliguese, Ligji mbi Prokurimet Publike, Ligji mbi Përmbartimin dhe Sigurimin, Ligji mbi Fiskalizimin në Qarkullimin e Prodhimeve dhe Shërbimeve, Ligji mbi planifikimin e hapësirës he ndërtimin e objekteve etj.).


2.5. Struktura pronësore

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz është themeluar si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar dhe si e tillë është në pronësi të Kuvendit të Komunës së Tuzit.

2.6. Organizimi i brendshëm dhe skema organizative

Në pajtim me Statutin, Shoqëria ka përgatitur Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, që do të zbatohen nga janari i vitit 2022, është rregulluar organizimi që do të ketë për qëllim kryerjen cilësore të punëve të besuara.



2.7. Veprimtaritë themelore dhe dytësore që kryen Shoqëria

Veprimtaritë themelore dhe dytësore që kryen Shoqëria dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin qendror të subjekteve ekonomike janë të definuara me Statutin e Shoqërisë.

Me statutin e Shoqërisë është definuar veprimtaria themelore që kryen Shoqëria, e që është në interesin publik dhe është e regjistruar në Regjistrin qendror të subjekteve ekonomike me shifrën:

- ndërton, mirëmban dhe menaxhon objektet e tregut;
- mirëmban higjienën e përgjithshme në hapësirat e tregut dhe objektet tjera që janë në pronësi të Komunës së Tuzit;
- përgatit dhe realizon programe nga fusha e investimeve;
- investimin dhe ndërtimin e objekteve me investime të përbashkëta me investues të tjerë;
- me dhënie në qira dhe menaxhimin e këtyre patundshmërive;

2.8. Organet e udhëheqjes dhe drejtimit

Shoqërinë e udhëheq Themeluesi në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me Vendimin mbi themelimin në bazë të Statutit të Shoqërisë, me ç'gjë sigurohet interesi publik.

Kuvendi i komunës së Tuzit:

- miraton aktin e themelimit, ndryshimet dhe plotësimet e aktit të themelimit të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për Statutin e Shoqërisë;
- shqyrton raportin mbi punën dhe sjell Vendimin mbi shpërndarjen e profitit;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit të drejtorëve;
- sjell vendimin mbi ndryshimin e formës, ristrukturimin dhe likuidimin vullnetar të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për ndryshimin e emërimit, veprimtarisë, selisë dhe kapitalit themelor të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për listën e çmimeve të shërbimeve, të cilën e përcakton Bordi i drejtorëve;
- kryen veprime të tjera në pajtim me ligjin, Vendimin mbi themelimin dhe Statutin.

Organet e Shoqërisë janë: Bordi i drejtorëve si organ i drejtimit dhe Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes së Shoqërisë;

Bordi i drejtorëve:

- drejton Shoqërinë dhe jep udhëzime drejtorit ekzekutiv në aspektin e udhëheqjes së punëve të Shoqërisë;
- sjell Statutin e Shoqërisë, me pajtim të themeluesit;

-
- emëron drejtorin ekzekutiv;
 - i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues,
 - përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe sjell akte për zbatimin e saj në pajtim me udhëzimet e themeluesit;
 - kryen mbikëqyrjen e udhëheqjes së Shoqërisë,
 - sjell planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, në pajtim me themeluesin;
 - i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor mbi realizimin e planit vjetor të punës si dhe dëshmisë financiare;
 - përcakton listën e çmimeve për kryerjen e shërbimeve të Shoqërisë, në pajtim me themeluesin;
 - i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
 - sjell aktin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në pajtim me kryetarin e Komunës;
 - përcakton politikat e kontabilitetit të Shoqërisë dhe politikës së menaxhimit të rizikut;
 - jep dhe shkarkon prokurën;
 - miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv mbi veprimtarinë e Shoqërisë;
 - sjell Rregulloren e procedurave mbi punën e Bordit të drejtorëve;
 - kryen detyra tjera në pajtim me ligjin dhe Statutin e Shoqërisë;

Bordi i drejtorëve përbëhet nga pesë anëtarë, që janë përfaqësuese të Themeluesit.

Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes së Shoqërisë:

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë;
 - lidh kontrata në emër të Shoqërisë;
 - organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë;
 - menaxhon pasurinë e Shoqërisë;
 - zbaton vendimet e Bordit të drejtorëve;
 - vendos mbi dispozicionin e mjeteve financiare të Shoqërisë;
 - propozon programe dhe plane në fushat për të cilat është themeluar Shoqëria;
 - përgatit propozimin e planit vjetor të punës dhe planit financiar të Shoqërisë;
 - përgatit raportin vjetor mbi realizimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë si dhe dëshminë financiare;
 - vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtim me ligjin;
 - kryen dhe detyra të tjera lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë, në pajtim me ligjin, me këtë Vendim dhe me Statutin e Shoqërisë;
-

Shoqëria është e obliguar që ta informojë vazhdimisht themeluesin dhe subjektet tjera që shprehin interes juridik për përcjelljen e punës dhe funksionimin e shoqërisë.

3. KAPACITETET E USHTRUESIT TË VEPRIMTARISË KOMUNALE

3.1. Resurset njerëzore

Për realizimin e qëllimeve dhe detyrave programore, shoqëria do të ketë në dispozicion 24 të punësuar për kryerjen e detyrave të besuara.

3.2. Politika e punësimit

Për realizimin e aktiviteteve të përmendura në Programin e kryerjes së veprimtarive komunale, Shoqëria do të ketë në dispozicion 55 të punësuar. Ky numër i të punësuarve është i paraparë me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, kështu që Shoqëria do të ketë mundësi për punësime të reja për ata punëtorë që do të jenë të domosdoshëm për servisimin e rregullt të punëve të besuara.

3.3. Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Me qëllim të zbatimit të veprimtarisë komunale të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace / Tregu" Tuz veprimtarinë komunale, për të cilën është themeluar, do t'i kryejë në objektet që vijnë:

1. Tregu i gjelbër	Tuzi p.n.
2. Tregu i përzier	Tuzi p.n.

Tregu i përzier në Tuz ka në dispozicion 348 hapësira afariste – të tregut dhe 50 lokacione.

Tregu i gjelbër ka në dispozicion 25 vende të shitjes, një sektor për djathë, mish dhe 6 vende të shitjes për peshk. Në kuadër të tregut të gjelbër ekziston edhe lokali afarist, të cilin e jep në qira Shoqëria.

3.4. Pajisjet dhe parku i makinave

Shoqëria ende nuk ka të definuara pajisjet, përpos pajisjeve që gjenden në tregje.

4. QËLLIMET E SHOQËRISË

Qëllimet e Shoqërisë do të orientohen në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve të tregut. Me mirëmbajtjen e objekteve dhe higjienës së tregut do të garantohet vend i sigurt dhe të parrezikshëm për kryerjen e punëve të besuara. Në zonën e Tuzit ekziston edhe një numër i madh i ekonomive bujqësore, që tepricat e prodhimit të vet i plasojnë në tregun e gjelbër, që është i njohur si vend ku mund të gjenden prodhimet vendore. Gjithashtu edhe tregu i përzier është i njohur për numrin e madh të vizituesve dhe si vend i tregtisë së llojllojshme, për

këtë arsye një numër i madh i qytetarëve nga komunat fqinje vizitojnë objektet tona të tregut. Lidhur me këtë, Shoqëria do të ketë si qëllim avancimin e kushteve të punës në tregje si dhe për punën e saj të njihet si Shoqëri që do të kryejë me sukses veprimtarinë me interes publik.

Me organizimet e planifikuara, në vitin 2022 Shoqëria do të angazhohet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e plotësimit të kapaciteteve të tregut.

Me qëllim të evitimit të sëmundjes ngjitëse COVID 19, kjo shoqëri do të zbatojë masat për mbajtjen e maskave mbrojtëse me rastin e hyrjes në objekte të tregut.

Të gjithë vizituesit që të hyjnë në objekt, duhet ta kenë maskën mbrojtëse, në hyrje të objektit do të'i dezinfektojnë duart. Do të bëhet dezinfektimi detajuar i objekteve.

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Pijace / Tregu" Tuz, me "Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022, planifikon të realizojë rezultat pozitiv financiar në shumën prej 4.183 €, gjë që është e dhënë në pasqyrën tabelore të Bilancit të suksesit.

5. BAZAT PËR PËRPILIMIN E PROGRAMIT

Përpilimin i Programit të kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022 është i bazuar në Rregulloren mbi përmbajtjen e përafërt vjetore të programit vjetor të kryerjes së veprimtarisë komunale dhe në bazë të të ardhurave dhe daljeve të

- Tregu i mallrave të përziera

Vendet e shitjes	TË ARDHURAT NË BAZË TË KAPACITETIT		TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022	
	Numri i përgjithshëm i vendeve të shitjes	Të ardhurat në bazë të të gjitha vendeve të shitjeve	Nr. mesatar i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të të gjitha vendeve të shitjes
Vendet e shitjes	315	248.585	174	141.167
lokacionet	50	85.968	44	75.273
Gjithsejtë	365	334.553	223	216.440

Të ardhurat e planifikuara janë bërë në bazë të plotësimit të kapaciteteve prej 65%.

- Llogaritja e të ardhurave në bazë të pagesa ditore në Tregun e mallrave të përziera

Vendet e shitjes	TË ARDHURAT NË BAZË TË KAPACITETIT		TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022	
	Numri i përgjithshëm i vendeve të shitjes	Të ardhurat në bazë të të gjitha vendeve të shitjeve	Nr. mesatar i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të të gjitha vendeve të shitjes
Vendet e shitjes	33	27.823	27	22.861
lokacionet	100	47.085	4	2.021
Gjithsejtë	133	74.908	31	24.882

Të ardhurat e planifikuara nga pagesa ditore janë bërë në bazë të plotësimit të kapaciteteve prej 33 %.

• Tregu i gjelbër

Vendet e shitjes	TË ARDHURAT NË BAZË TË KAPACITETIT		TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022	
	Numri i përgjithshëm i vendeve të shitjes	Të ardhurat në bazë të të gjitha vendeve të shitjeve	Nr. mesatar i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të të gjitha vendeve të shitjes
Vendet e shitjes	20	248.585	18	8.926
Sektori i djathit, peshkut, mishit	8	6.942	4	1.240
Hapësira afariste	1	2.083	1	2.083
Gjithsejtë	29	18.942	23	12.249

Të ardhurat e planifikuara janë bërë në bazë të plotësimit të kapaciteteve prej 65%.

• Llogaritja e të ardhurave në bazë të pagesës ditore në Tregun e gjelbër

Vendet e shitjes	TË ARDHURAT NË BAZË TË KAPACITETIT		TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022	
	Numri i përgjithshëm i vendeve të shitjes	Të ardhurat në bazë të të gjitha vendeve të shitjeve	Nr. mesatar i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të të gjitha vendeve të shitjes
Vendet ditore të shitjes (tezga)	5	7.573	---	235
Gjithsejtë	5	7.573	---	235

6. TREGUESIT E PLANIFIKUAR FINANCIARË

Në pjesën në vijim është dhënë pasqyra tabelorei planit financiar për vitin 2022.

DËSHMIA MBI REZULTATIN /BILANCI I SUKSESIT / PLANI 2022

Grupi i faturave, faturat	POZICIONI	nr. rend.	Vërejtje e numri	Shuma
				Plani viti 2022
1	2	3	4	6

60 dhe 61	1. Të ardhurat nga shitja – të ardhurat neto	201		25.135
630 dhe 631	2. ndryshimi i vlerës së rezervave të prodhimeve të gatshme dhe prodhimit të papërfunduar	202		
62	3. Të ardhurat nga aktivimi i efekteve dhe mallit	203		
	4. të ardhurat tjera nga veprimtaria (205 deri 207)	204		278.689
64 dhe 65	a) Të ardhurat tjera nga veprimtaria e rregullt	205		278.689
67, 691 dhe 692	b) të ardhurat tjera nga veprimtaria	206		
68, përpos 683,685	c) Të ardhurat në bazë të nivelimit të vlerës së pronës	207		
	5. Shpenzimet afariste (209+210)	208		104.621
50 dhe 51	a) Vlera blejëse e mallit të shitur dhe shpenzimet e materialit	209		32.476
53, 54 dhe 55	b) të ardhurat tjera nga veprimtaria (amortizimi, rezervimet dhe të dalat tjera afariste)	210		72.145
	6. Shpenzimet e rrogave, pagimi i rrogave dhe të dalat tjera personale (212+213)	211		195.020
52 (një pjesë)	a) shpenzimet neto të rrogave, pagimi i rrogës dhe të dalat tjera personale	212		119.495
	b) Shpenzimet e tatimeve dhe kontributeve (214 do 216)	213		75.525
52 (një pjesë)	1/ Shpenzimet e tatimeve	214		16.010
52 (një pjesë)	2/ Shpenzimet për kontribute për pensione	215		36.466
52 (një pjesë)	3/ Shpenzimet e kontributeve	216		23.049
	7. Daljet në bazë të nivelimit të vlerës së pasurisë (përpos asaj financiare) (218+219)	217		
580, 581, 582, 589 (një pjesë)	a) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mallit të përhershëm (financiar)	218		
584, 589 (një pjesë)	b) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mallit qarkullues (përpos atij financiar)	219		
57, 591 dhe 592	8. Të dalat tjera afariste	220		
	Rezultati afarist (201+202+203+204-208-211-217-220)	221		
	9. Të ardhurat në bazë të pjesëmarrjes në kapital (223 deri 225)	222		
660 (një pjesë)	a) Të ardhurat në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personave të varur juridikë	223		
661 (një pjesë)	b) Të ardhurat në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personave tjerë juridikë të lidhur	224		
669 (një pjesë)	c) Të ardhurat në bazë të pjesëmarrjes në kapital të personave juridikë të palidhur	225		

	10. Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare (interesi, ndryshimet e kursit dhe efektet e mbrojtjes së kontraktuar) (227 deri 229)	226		
660 (një pjesë)	a) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare prej personave juridikë amë dhe të varur	227		
661 (një pjesë)	b) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare prej personave tjerë juridikë të lidhur	228		
662 (një pjesë), 663 (një pjesë), 664 (një pjesë), 669 (një pjesë)	c) Të ardhurat në bazë të investimeve dhe huazimeve tjera financiare nga persona juridikë të palidhur	229		
	11. Të ardhurat tjera në bazë të interesit, ndryshimeve të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar (231 deri 233)	230		
660 (një pjesë)	a) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga personi juridik amë dhe personave juridikë të varur	231		
661 (një pjesë)	b) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga persona tjerë juridikë të lidhur	232		
662 (një pjesë), 663 (një pjesë), 664 (një pjesë), 669 (një pjesë)	c) Të ardhurat financiare në bazë të kërkesave aktuale nga persona tjerë juridikë të palidhur	233		
	12. Nivelimi i vlerës së mjeteve afatshkurtra financiare dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë e qarkullueshme (235-236)	234		
683, 685	a) Nivelimi i vlerës së mjeteve afatshkurtra financiare dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë e qarkullueshme	235		
583, 585	b) Të dalat në bazë të nivelimit të vlerës së mjeteve financiare afatshkurtra dhe investimeve financiare që janë pjesë e pasurisë së qarkullueshme	236		
	13. Të dalat në bazë të interesit (kamatës), ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar (238 deri 240)	237		
560	a) Të dalat në bazë të interesit, ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit me personin juridik amë dhe persona tjerë të varur juridikë	238		
561	b) Të dalat në bazë të interesit, ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit me persona tjerë të lidhur	239		
562, 563, 564, 569	c) Të dalat në bazë të interesit, ndryshimit të kursit dhe efekteve tjera të mbrojtjes së kontraktuar në bazë të raportit	240		

	me persona tjerë të palidhur			
	II. Rezultati financiar (222+226+230+234-237)	241		
	III. Rezultati i afarizmit të rregullt para tatimit (221+241)	242		4.183
690 – 590	IV. Neto rezultati i afarizmit që është zbritur	243		
	V. Rezultati para tatimit (242+243)	244		4.183
	14. Të dalat tatimore të periudhave (246+247)	245		
721	1. Tatimi aktual në fitim	246		
722	2. Të dalat apo të hyrat tatimore të prolonguara	247		
	15. Fitimi apo humbja pas tatimit (244-245)	248		4.183
	VI. REZULTATI BRUTO I POZICIONEVE TJERA TË REZULTATIT /TË LIDHURA ME KAPITALIN / (250 do 257)	249		
330	1. Ndryshimi i rezervave të valorizuara në bazë të patundshmërisë, makinerive, pajisjeve, investimeve jomateriale dhe mjeteve biologjike	250		
331	2. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të përealizuara në bazë të përlogaritjes së raporteve financiare të afarizmit të huaj	251		
332	3. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të përealizuara në bazë të investimeve në instrumentet pronësore të kapitalit	252		
333	4. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve aktuale në bazë të planeve të kompensimeve të definuara të fitimeve (ose humbjeve) aktuale lidhur me planet e definuara të kompensimeve për pensione.	253		
334	5. Ndryshimi i pjesëmarrjes në rezultatit tjetër gjithëpërfshirës të shoqërisë së bashkëngjitur	254		
335	6. Ndryshimet e fitimeve dhe humbjeve të përealizuara në bazë të instrumenteve të mbrojtjes së investimeve neto në afarizmin e jashtëm	255		
336	7. Ndryshimet e rezervave të rivalorizuara në bazë të hexhingut (hedging) dhe rrjedhave të parave të thata	256		
337	8. Ndryshimet tjera të fitimeve dhe humbjeve të përealizuara	257		
	VII. TË DALAT OSE TË HYRAT E PROLONGUARA TATIMORE NË PERIUDHË LIDHUR ME POZICIONET TJERA TË REZULTATIT /TË LIDHURA ME KAPITALIN /	258		
	VIII. NETO REZULTATI I POZICIONEVE TJERA TË REZULTATIT /TË LIDHURA ME KAPITALIN/ (249-258)	259		
	IX. REZULTATI GJITHPËRFSHIRËS NETO (248-259)	260		4.183
	X. FITIMI PËR AKSION	261		
	1. fitimi bazë për aksion	262		

	2. Zbritjet e fitimit për aksion	263		
	XI. REZULTATI NETO QË U TAKON PRONARËVE TË PERSONIT JURIDIK AMË	264		
	XII. REZULTATI NETO QË U TAKON PJERSËMARRJEVE QË NUK E SIGUROJNË KONTROLLIN	265		

8.Struktura e të ardhurave dhe daljeve

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022 pritët pozitivitet afarist i Shoqërisë dhe realizimet e fitimit prej 4.183 €.

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022 – me Planin financiar, “Pijace/Tregu” sh.p.k. Tuz, planifikohen të ardhura të përgjithshme prej 303.824 € .

Të ardhurat e planifikuara në bazë të të ardhurave të realizuara në Shoqërinë “Pijace/Tregu” sh.p.k. në vitin 2021 dhe të ardhurave të realizuara në Shoqërinë “Komunalno/Komunale” sh.p.k. po në vitin 2021.

Në pozicionin me numrin rendor 1, grupi i llogarive 61 – të ardhurat nga shitja/neto, të ardhurat prej 25.135 € i përbëjnë

- të ardhurat nga shitja e mallit dhe shërbimeve / ofrimi i shërbimeve të shpenzimit individual komunal, gjë që përbën veprimtarinë kryesore të kësaj shoqërie me interes publik (veprimtari komunale). Konkretisht kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve prodhuesve bujqësorë në Tregun e gjelbër/ pagesa ditore;
- të ardhurat e planifikuara në shumën prej 235 €.

Ofrimi i shërbimeve në Tregun e mallit të përzier /pagesa ditore;

-të ardhurat e planifikuara 24.882 €

Në pozicionin me numër rendor 4, të ardhurat tjera nga afarizmi i rregullt grupet e llogarive 64 dhe 65 në shumën prej 278.689 € përbëjnë:

grupet e llogarive 64 nga donacionet (Komuna e Tuzit), të planifikuara në shumën 50.000€, grupet e llogarive 65-të ardhurat nga qiraja (ndarja e hapësirave afariste, lokacionet, vendet e shitjes dhe) me qiramarrësit sipas kontratave të nënshkruara si në Tregun e gjelbër, ashtu edhe në Tregun e mallit të përzier është në shumën prej 228.689€. Në tregun e gjelbër janë të planifikuara të ardhurat prej 12.249, ndërsa në Tregun e mallit të përzier shuma është 216.440. Këto të ardhura i takojnë veprimtarisë shtesë të Shoqërisë.

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022 – me Planin financiar «Pijace/Tregu» sh.p.k. – Tuz, planifikohen të dala në shumën prej 282.991 €.

Llogaritë e grupit 50 dhe 51 në shumën prej 32.476 € i përbëjnë:

-Shpenzimet për materiale (të zyrave, materiali për higjienë, inventari i imët etj.) në shumë prej 5.000 €,

-shpenzimet e karburantit dhe lubrifikuesve në shumë prej 6.050 €,

-shpenzimet e energjisë elektrike në shumën prej 21.426 €.

Llogarinë e grupit 52 e përbëjnë shpenzimet e bruto të ardhurave 195.020 €.

Struktura e këtyre shpenzimeve është detajuar taksativisht në bilancin e suksesit. Shpenzimet nga ky grup janë planifikuar në bazë të numrit minimal të të punësuarve që janë të domosdoshëm për qëndrueshmërinë dhe procesin e punës së kësaj Shoqërie. Në shpenzimet e planifikuara nuk është llogaritur stazhi i punës, ngase momentalisht nuk është e njohur struktura e moshës së të punësuarve.

Llogaritë e grupit 53, 54 dhe 55 në shumën prej 72.145 € e përbëjnë:

9. POLITIKA E RROGQAVE DHE PUNËSIMIT

Numri i planifikuar i të punësuarve sipas njësive organizative dhe në tërësi si dhe struktura e kualifikimit të tyre për vitin 2022 është dhënë në tabelën 1.

Tabela 1

LLOJI I PUNËS		Të punësuar në vitin 2022	Niveli i kualifikimit								Gjithsejtë
			VI ose VII1 e më shumë	V	IV 1	IV 2	III	II	I1 ose I2	Të tjerët	
1		2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Punët e menaxhimit – drejtimit		3	3	/	/	/	/	/	/	/	3
Punët administrative – teknike		6	4	/	2	/	/	/	/	/	6
Punët financiare – të kontabilitetit		5	2	/	/	3	/	/	/	/	5
Punët juridike		2	2	/	/	/	/	/	/	/	2
Veprimtaria themelore	Tregu i gjelbër	7	1	/	4	/	/	/	2	/	7

	Tregu i përzier	16	1	/	10	/	/	/	5	/	16
Punët logjistike		13	/	/	13	/	/	/	/	/	16
GJITHSEJTË		55		/		/		/		/	55

Vërejtje: Punët logjistike janë: vendi i punës roje, përgatitëse e kafesë, vozitës /portier/korrier

10. BORXHI

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022, Shoqëria nuk planifikon borxh kreditor.

11. PLANI I PROKURIMIT PUBLIK

	Emri i lëndës së prokurimit publik	Vlera e projektuar e prokurimit publik	Vlera e TVSH-së
I.	M A L L I		
1.	Karburanti dhe lubrifikantët	5.000,00	1050,00
2.	Prokurimi i materialit për zyra dhe materialit tjetër	4.132,23	867,77
3.	Reprezentacioni dhe shpenzimet e bufesë	826,45	173,55
4.	Prokurimi i mobileve për zyra	5.000,00	1.050,00
5.	Prokurimi i kompjuterëve	5.000,00	1.050,00

6.	Prokurimi dhe montimi i kamerave të sigurisë	4.132,23	867,77
7.	Sanimi i problemit të furnizimit me energji elektrike në Tregun e mallit të përzier	5.000,00	1.050,00
8.	Rikonstruktimi i objekteve të tregut në tregun e mallit të përzier (zyra, tualetet)	5.000,00	1.050,00
II.	SHËRBIMET		
1.	Shërbimet e dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit	599,18	125,82
2.	Mirëmbajtja e objekteve sportive	8.795,04	1.846,96
3.	Shërbimet tjera (shërbimet e konsultimit, shërbimet e dokumentimit)	495,87	104,13

12. POLITIKA E ÇMIMEVE

12.1. Prolongimi i prurjes së listës së çmimeve

Në bazë të Ligjit mbi Veprimtarinë Komunale dhe në pajtim me Dekretin mbi elementet e përafërta dhe metodologjisë për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve komunale (Flet. Zyrt. MZ, nr.55/20 datë 12.06.2020) Shoqëria do ta sjellë Listën e çmimeve të shërbimeve, me të cilën përcaktohen çmimet për mirëmbajtjen e tregjeve, që janë kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve dhe janë me interes publik, si dhe listën e çmimeve për dhënie e objekteve afariste në qira.

Situata ekonomike e shkaktuar me covid, që është reflektuar në jetën e qytetarëve në tërësi, pra edhe në kushtet e afariste në të gjitha objektet e tregjeve ka ndikuar në prolongimin e miratimit të listës së çmimeve në pajtim me dispozitat ligjore.

Shoqëria nuk do t'i ndryshojë çmimet e qirasë në tregun e mallit të përzier, që para ndarjes i ka takuar Kryeqytetit Podgorica dhe organet e drejtimit do të miratojnë lista të njëjta të çmimeve, që ishin në fuqi edhe në Kryeqytetin Podgorica, e kanë të bëjnë me tregjet e mallit të përzier. Kjo, për shkak të ruajtjes së qiramarrësve ekzistues.

Duke pasur parasysh të gjitha të sipërpërmendurat, është vendosur që të prolongohet akordimi i listës së çmimeve, ngase kjo do të ndikonte negativisht në fuqinë ekonomike të qiramarrësve dhe medoemos do të binte deri te rritja e çmimit të qirasë për shkak të rritjes së shpenzimeve të elementeve që ndikojnë në formimin e çmimit.

13. VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2022, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz planifikon ta sigurojë vazhdueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të konsumit individual komunal, të vazhdojë me dhënien në qira të hapësirave të tregut që gjenden në objektet e tregjeve dhe prej tyre të realizojë të ardhura.

Shoqëria do të vazhdojë me mirëmbajtjen në vijimësi të objekteve të tregut, duke pasur kujdes që të sigurohet interesi publik dhe stabiliteti në veprimtari.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Pijace / Tregu“ Tuz me Programin për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2022 planifikon të realizojë rezultat **pozitiv** financiar në shumën prej **4.183 €**.

BORDI I DREJTORËVE
SHPK „PIJACE/TREGU“ TUZ
KRYETAR
DEMIR DRESHEVIQ

